| 378 | 84591000 | Makinat koke-njesi te tipit-vije |
| 379 | 84592100 | Te kontrolluara numerikisht |

| | | |
|---|---|---|
| 380 | 84593100 | Te kontrolluara numerikisht |
| 381 | 84594010 | Te kontrolluara numerikisht |
| 382 | 84595100 | Te kontrolluara numerikisht |
| 383 | 84596110 | Makineri vijezimi me vegla |
| 384 | 84596910 | Makinat vijezuese me vegla |
| 385 | 84597000 | Makineri te tjera filetimi apo berje filetosh |
| 386 | 84601100 | Te kontrolluara numerikisht |
| 387 | 84601900 | Te tjera |
| 388 | 84602111 | Makinat lemuese cilindrike te brendshme |
| 389 | 84602115 | Makina lemuese pa qendra |
| 390 | 84602119 | Te tjera |
| 391 | 84602190 | Te tjera |
| 392 | 84602911 | Makinat lemuese cilindrike te brendshme |
| 393 | 84602919 | Te tjera |
| 394 | 84602990 | Te tjera |
| 395 | 84603100 | Te kontrolluara numerikisht |
| 396 | 84603900 | Te tjera |
| 397 | 84604010 | Te kontrolluara numerikisht |
| 398 | 84604090 | Te tjera |
| 399 | 84609010 | Te pershtatura me nje sistem pershtatjeje mikrometrik, ne të cilin pozicionimi i cdo njerit prej akseve mund vendoset me nje saktesi prej te pakten 0,01 mm |
| 400 | 84609090 | Te tjera |
| 401 | 84612000 | Makinat e perpunimit me shtypje ose gdhendjes |
| 402 | 84613010 | Te kontrolluara numerikisht |
| 403 | 84613090 | Te tjera |
| 404 | 84614011 | Te kontrolluara numerikisht |
| 405 | 84614019 | Te tjera |
| 406 | 84614031 | Te kontrolluara numerikisht |
| 407 | 84614039 | Te tjera |
| 408 | 84614071 | Te kontrolluara numerikisht |
| 409 | 84614079 | Te tjera |
| 410 | 84614090 | Te tjera |
| 411 | 84615011 | Sharra rrethore |
| 412 | 84615019 | Te tjera |
| 413 | 84615090 | Makinat e keputjes |
| 414 | 84619000 | Te tjera |
| 415 | 84621010 | Te kontrolluara numerikisht |
| 416 | 84621090 | Te tjera |
| 417 | 84622110 | Per punimin e produkteve te sheshta |
| 418 | 84622180 | Te tjera |
| 419 | 84622905 | Makina te perkuljes, palosjes, drejtimit o sheshimi(perf.prese), per prodhim gjysempercuesi |
| 420 | 84622910 | Per punimin e produkteve te sheshta |
| 421 | 84622991 | Hidraulike |
| 422 | 84622998 | Te tjera |
| 423 | 84623100 | Te kontrolluara numerikisht |
| 424 | 84623910 | Per punimin e produkteve te sheshta |
| 425 | 84623991 | Hidraulike |
| 426 | 84623999 | Te tjera |
| 427 | 84624110 | Per punimin e produkteve te sheshta |
| 428 | 84624190 | Te tjera |
| 429 | 84624910 | Per punimin e produkteve te sheshta |
| 430 | 84624990 | Te tjera |
| 431 | 84629110 | Presa per tu dhene forme pluhurave metalike nepermjet pjekjes apo presave per kompresimin e mbetjeve metalike ne tufe |

| | | |
|---|---|---|
| 432 | 84629150 | Per punimin e produkteve te sheshta |
| 433 | 84629190 | Te tjera |
| | | Presa per tu dhene forme pluhurave metalike nepermjet pjekjes apo presave per kompresimin e mbetje |
| 434 | 84629910 | metalike ne tufe |
| 435 | 84629950 | Per punimin e produkteve te sheshta |
| 436 | 84629990 | Te tjera |
| 437 | 84631010 | Bangat e terheqjes per tela |
| 438 | 84631090 | Te tjera |
| 439 | 84632000 | Makinat e berjes se vidhes |
| 440 | 84633000 | Makinat per perpunimin e telit |
| 441 | 84639000 | Te tjera |
| 442 | 84641010 | Makine sharrimi per sharrim bulbi monokristal gjysempercjelles ne feteza (perf.vaferet) |
| 443 | 84641090 | Te tjera |
| 444 | 84642005 | Makinat mprehese ose lustruese,per punimin e vafereve gjysempercuese. |
| 445 | 84642019 | Te tjera |
| 446 | 84642020 | Per punimin e qeramikave |
| 447 | 84642095 | Te tjera |
| 448 | 84649010 | Vegla-makine per shkrimin apo gerryer e vafereve gjysempercues. |
| 449 | 84649020 | Per punimin e qeramikave |
| 450 | 84649080 | Te tjera |
| 451 | 84651010 | Me tranferim manual te punimeve midis cdo operacioni |
| 452 | 84651090 | Me trasferim manual i punimeve midis cdo operacioni |
| 453 | 84659110 | Sharrat shirrit |
| 454 | 84659120 | Sharrat rrethore |
| 455 | 84659190 | Te tjera |
| 456 | 84659200 | Makinat e zdrukthtimit, petezimit ose te dhenies forme (nga prerja) |
| 457 | 84659300 | Makinat e mprehjes, imtesimit ose lustrimin |
| 458 | 84659400 | Makinat e bashkimit ose te perkuijes |
| 459 | 84659500 | Makinat e shpimit ose prerjes per bashkim te dy copave druri |
| 460 | 84659600 | Makinat e carjes, prerjes me thela ose prerjes |
| 461 | 84659910 | Tornot |
| 462 | 84659990 | Te tjera |
| 463 | 84669115 | Koka ndarese e bashkangjitjet speciale, per makina te nenkre.84641010,84642005 o 84649010 |
| 464 | 84681000 | Pipat fryrese qe mbahen ne dore |
| 465 | 84682000 | Makineri dhe aparate te tjera qe veprojne me gaz |
| 466 | 84688000 | Makineri dhe aparate te tjera |
| 467 | 84691200 | Shtypshkrues automatik(jo:e perpunimit te fjaleve,automatike e perpunimit te te dhenave) |
| 468 | 84692000 | Shtypshkryes elektrike(jo:automatik, perpunim automatik te dhenash me njesinë e tyre etj) |
| 469 | 84693000 | Shtypshkrues joelektrik. |
| 470 | 84741000 | Makinat e zgjedhjes, shoshimit, vecimit ose larjes |
| 471 | 84742010 | Per substancat minerale te nje lloji te perdorur ne industrine qeramike |
| 472 | 84742090 | Te tjera |
| 473 | 84743100 | Perzieresit e betonit ose llacit |
| 474 | 84743200 | Makinat per perzierjen e substancave minerale me bitum |
| 475 | 84743910 | Makineri per trazimin ose perzierjen e substancave minerale te nje lloji te perdorur ne industrinë qeramik |
| 476 | 84743990 | Te tjera |
| 477 | 84748010 | Makineri per agomerim, formim apo dhenie forme te pastave qeramike |
| 478 | 84748090 | Te tjera |
| | | Makinat per montimin e llampave elektrike ose elektronike, tubave ose |

| | | |
|---|---|---|
| | | valvolave ose dritave te ndricim |
| 479 | 84751000 | flash, ne mbulesa xhami |
| 480 | 84752100 | Makinat per pergatitjen e fibrave optike dhe paraformat prej tyre |
| 481 | 84752900 | Te tjera |
| 482 | 84771090 | Te tjera |
| 483 | 84772000 | Nxjerresit |
| 484 | 84773000 | Makinat me fryrje kallep |
| 485 | 84774000 | Makinat me kallepe vakumi dhe makinat e tjera termoformuese |
| | | Per formim me kallepe ose ritrajtimin e gomave pneumatike ose per fomimin me kallepe apo ndryshe |
| 486 | 84775100 | formim te tubave te brendshem |
| 487 | 84775905 | Pajisje enkapsuluese per montimin e mjeteve gjysempercuese,per dhenie forme me kallep |
| 488 | 84775910 | Presat |
| 489 | 84775980 | Te tjera |
| 490 | 84778011 | Makina per perpunimin e rezinave aktive |
| 491 | 84778019 | Te tjera |
| 492 | 84778091 | Pajisje per reduktim dimensionesh |
| 493 | 84778093 | Makina trazuese, perzjerese dhe tundese |
| 494 | 84778095 | Makinat prerese, ndarese, zhveshese |
| 495 | 84778099 | Te tjera |
| 496 | 84779005 | Pjese per paisje encapsulation injektim-formim me kallep o per pajisje formuese |
| 497 | 84781000 | Makineri |
| 498 | 84789000 | Pjeset |
| 499 | 84792000 | Makineri per nxjerrjen ose pergatitjen e vajrave ape yndyrnave bimore apo shtazore |
| 500 | 84793010 | Presat |
| 501 | 84793090 | Te tjera |
| 502 | 84794000 | Makinat per berjen e litarit ose kabllove |
| 503 | 84795000 | Robote industriale. |
| 504 | 84798100 | Per trajtimin e metalit, perfshi mbledhesat e bobinave me tel elektrik |
| | | Makinat perzierjes, perzierjes se brumit, shtypjes, bluarjes, shoshimin, sitjen, homogjenizimin, emulsifik |
| 505 | 84798200 | ose tronditjen |
| 506 | 84798930 | Mbeshtetesit e tavaneve te minierave te fuqizuara, hidraulike, te levizishme |
| 507 | 84798960 | Sistemet qendrore te grasatimit |
| 508 | 84798965 | Aparatura per rritjen apo terheqjen e bulbeve gjysempercuese monokristal. |
| 509 | 84798970 | Aparatura per depozitim epitaksial mbi vaferet gjysempercuese. |
| 510 | 84798973 | Aparatura per gdhendje ne te lagesht, zhvillim, drejtim o pastrim vaferesh gjysempercues |
| 511 | 84798977 | Aparature bashkangjitur me matrice e lidhes te automatizuar me shirit per montim mjetesh |
| 512 | 84798979 | Paisje enkapsulimi per montimin e mjeteve gjysempercuese. |
| 513 | 84798991 | Makinat per glazurimin dhe dekorimin e produkteve qeramike |
| 514 | 84798998 | Te tjera |
| 515 | 84801000 | Kutite kallepe per fonderine e metaleve |
| 516 | 84802000 | Bazat e kallepeve |
| 517 | 84803010 | Prej druri |
| 518 | 84803090 | Te tjera |
| 519 | 84804110 | Tipet me injeksion ose shtypje |
| 520 | 84804900 | Te tjera |
| 521 | 84805000 | Kallepet per qelqet |

| | | |
|---|---|---|
| 522 | 84806010 | Tipet me shtypje |
| 523 | 84806090 | Te tjera |
| 524 | 84807110 | Kallepe te tipit me injeksion ose shtypje, per prodhimin e mjeteve gjysempercuese. |
| 525 | 84807190 | Te tjera |
| 526 | 84807900 | Te tjera |
| 527 | 84811005 | Te kombinuar me filtra apo lubrifikatore |
| 528 | 84811019 | Me hekur dhe celik te derdhur |
| 529 | 84811099 | Te tjera |
| 530 | 84812010 | Valvolat per kontrollin e transmisionit me fuqi oleohidraulike |
| 531 | 84812090 | Valvolat per kontrollin e transmisionit me fuqi pneumatike |
| 532 | 84813091 | Prej gize te derdhur apo celiku te derdhur |
| 533 | 84813099 | Te tjera |
| 534 | 84814010 | Prej gize te derdhur apo celiku te derdhur |
| 535 | 84814090 | Te tjera |
| 536 | 84818011 | Valvolat perzierese |
| 537 | 84818019 | Te tjera |
| 538 | 84818031 | Valvolat termostatike |
| 539 | 84818039 | Te tjera |
| 540 | 84818040 | Valvola per goma pneumatike dhe tuba te brendshem |
| 541 | 84818051 | Rregullatoret e temperatures |
| 542 | 84818059 | Te tjera |
| 543 | 84818061 | Prej gize te derdhur |
| 544 | 84818063 | Prej celiku |
| 545 | 84818069 | Te tjera |
| 546 | 84818071 | Prej gize te derdhur |
| 547 | 84818073 | Prej celiku |
| 548 | 848118079 | Te tjera |
| 549 | 84818081 | Valvolat sferike dhe zhytese |
| 550 | 84818085 | Valvolat flutura |
| 551 | 84818087 | Valvolat diafragme |
| 552 | 84818099 | Te tjera |
| 553 | 84819000 | Pjeset |
| 554 | 84842000 | Vulosesit mekanik. |
| 555 | 85011010 | Motor sinkron me nje dalje =<l8kw. |
| 556 | 85011091 | Motor universal IAC/DC me dalje= <37.5w |
| 557 | 85011093 | Motore AC me dalje= <37.5w(jo;motore sinkronik me dalje =<18w) |
| 558 | 85011099 | Motore DC me dalje =<37.5w. |
| 559 | 85012090 | Motor universal AD/DC me dalje=>37.5w(jo:universal AC/DC me dalje >735w por=<l5Okw etj.) |
| 560 | 85013110 | Motoret me nje dalje >735wpor=<750w,gjeneratoret DC me dalje<750w,pe |
| 561 | 85013190 | Motor DC me dalje >37.5w por =<750w e gjeneratore DC me dalje =<750w (jo:Dc dalja> |
| 562 | 85013210 | Motore e gjeneratore DC prej nje dalje >750W por nuk e kalon 75 kW, per avion civil. |
| 563 | 85013291 | Motor DC e gjeneratore me dalje >750w por<7.5kw(jo:per aviacion civil) |
| 564 | 85013299 | Motore DC e gjeneratore me dalje >7.5kw por=<75kw (jo:aviacion civil te kreut 850132-10 |
| 565 | 85013390 | Motor DC e gjeneratore me dalje >75kw deri 375 kw(ndryshe nga motor me dalje =<l5Okw e |
| 566 | 85013450 | Motoret traktion me nje dalje >375 kw. |
| 567 | 85013491 | Gjeneratore e motore DC,me dalje>375kw por =<750 (jo:gjeneratore per avion civil,) |

| | | |
|---|---|---|
| 568 | 85013491 | Motore dhe gjeneratore DC prej nje dalje qe e kalon 375 kW. |
| 569 | 85013499 | Gjeneratore e motore DC,me dalje>750kw (jo:gjenerator per avion civil e motore tra |
| 570 | 85013499 | Motore dhe gjeneratore DC prej nje dalje qe e kalon 375 kW. |
| 571 | 85014091 | Motor AC,njefazor me dalje >37.5w deri<=750w jo me dalje>735w deri l50kw,avi |
| 572 | 85014091 | Te tjere motore AC,njefazore,me dalje >37.5w. |
| 573 | 85014099 | Motor AC,njefazor me dalje >750w jo me dalje>735w deri l50kw,per aviacion civil) |
| 574 | 85015190 | Motor AC,shumefazor me dalje >37.5w por =<750w (jo: AC shumfazor me dalje >735w,avia |
| 575 | 85015291 | Motor AC,shumfazor me dalje >750w por=<7.5kw (jo:per aviacion civil) |
| 576 | 85015291 | Motore AC,shume fazore,me dalje qe e kalon 750 W por nuk e kalon 75 kW. |
| 577 | 85015293 | Motor AC,shumfazor me dalje >7.5kwpor=<37kw(jo:aviacion civil te nenkreut 850152 |
| 578 | 85015299 | Motor AC,shumfazor me dalje >37kw por=<75kw (jo: aviacion civil te nenkreut 85015 |
| 579 | 850115310 | Motore AC me dalje>75kW por =<l50kW- per perdorim ne aviacionin civil |
| 580 | 85015350 | Motore traction AC,shume-fazore,me dalje>75kW. |
| 581 | 85015392 | Motor AC,shumfazor me dalje>75kw deri375kw (jo:me dalje <=l50kw,aviacion civil) |
| 582 | 85015394 | Motor AC,shumfazor me dalje>375kw deri750kw(jo:me dalje <=150 aviacion civil) |
| 583 | 85015399 | Motor AC,shumfazor me dalje>750kw (jo:motor e traction) |
| 584 | 85016191 | Gjeneratore AC me dalje <75kva(jo:per aviacion civil te nenkrereve 850161-10) |
| 585 | 85016191 | Gjeneratore AC,me dalje qe nuk e kalon 75kva. |
| 586 | 85016199 | Gjeneratore AC me dalje >7.5 kva por =<75kva (jo: civil te nenkrereve 850) |
| 587 | 85016199 | Gjeneratore AC,me dalje qe nuk e kalon 75kva. |
| 588 | 85016290 | Gjeneratore AC me dalje >75 kva por=<375kva(jo:aviacion civil te nenkreut 8501) |
| 589 | 85016290 | Gjeneratore AC me dalje qe e kalon 75 kVApor nuk e kalon 375 kVA. |
| 590 | 85016390 | Gjeneratore AC me dalje >375kva por = <750 kva (jo:aviacion civil) |
| 591 | 85021110 | Grup gjenerator, motor me djegie te brendshme,tip shtypje-djegie,diesel/gjysem, |
| 592 | 85041091 | Induktoret, nese jane apo jo te lidhura me nje kapacitor |
| 593 | 85041099 | Te tjera |
| 594 | 85042100 | Transformator dielektrik likuid me kapacititet fuqie=<650 kva. |
| 595 | 85042100 | Qe kane nje kapacitet fuqie qe nuk e kalon 650 kVA |
| 596 | 85042210 | Me teper se 650 kVA por jo me teper se 1 600 kVA |
| 597 | 85042290 | Me teper se 1 600 kVA por jo me teper se 10 000 kVA |
| 598 | 85042300 | Qe kane nje kapacitet fuqie qe e kalon 10,000 kVA |
| 599 | 85043131 | Per matjen e voltazhit |
| 600 | 85043139 | Transformator mates ndryshe nga per matje voltazhi me kapacitet=<lkva (jo aviacion civil) |
| 601 | 85043139 | Te tjera |
| 602 | 85043190 | Transformator, ndryshe nga dielektrik i lenget,me kapacitet =<1lkva (jo:aviacion civil) |
| 603 | 85043190 | Te tjera |
| 604 | 85043230 | Transformator mates me kapacitet >lkva deri l6 kva(ndryshe nga per aviacion civil) |

| | | |
|---|---|---|
| 605 | 85043230 | Transformatoret mates |
| 606 | 85043290 | Te tjera |
| 607 | 85043390 | Te tjera |
| 608 | 85043400 | Qe kane nje kapacitet fuqie qe e kalon 500 kVA |
| 609 | 85049011 | Berthamat ferrite |
| 610 | 85049018 | Te tjera |
| 611 | 85049099 | Te tjera |
| 612 | 85051100 | Prej metali |
| 613 | 85051910 | Magnetet e perhershem prej ferriti te aglomeruar |
| 614 | 85051990 | Te tjera |
| 615 | 85052000 | Bashkuesit, lidhesat, frenat elektromagnetike |
| 616 | 85053000 | Kokat ngritese elektromagnetike |
| 617 | 85059010 | Elektro-magnetet |
| 618 | 85059030 | Kapese,kllapa elektromagnetike apo magnet i perhershem e mjete te ngjashme mbajtese |
| 619 | 85141005 | Furra o furnalta industrial/laboratorik;ngrohese,per prodhim mjeti gjysempercues |
| 620 | 85141010 | Furrat per biskota apo per produkte te furrtarit |
| 621 | 85141080 | Te tjera |
| 622 | 85142010 | Furrnaltat dhe furrat me induksion |
| 623 | 85142080 | Furrnaltat dhe furrat dielektrike |
| 624 | 85143011 | Furra infra te kuqe per prodhim te mjeteve gjysempercues mbi vafere gjysempercues. |
| 625 | 85143019 | Te tjera |
| 626 | 85143091 | Kaldaje e furra per laborator e industri,per prodhim mjeti gjysemëpercues mbi vafere |
| 627 | 85143099 | Furrnalta e furra per laborator e industri, elektrike(jo:furra me ngrohje did |
| 628 | 85143099 | Furra dhe furrnalta elektrike, idustriale ose laboratorike (jo:dielektrike, me induksion,) |
| 629 | 85144000 | Paisje te tjera ngrohje me induksion ose dielektrik |
| 630 | 85151100 | Qe saldojne hekurat dhe armet |
| 631 | 85151900 | Te tjera |
| 632 | 85152100 | Plotesisht ose pjeserisht automatike |
| 633 | 85152910 | Per saldimin butt |
| 634 | 85152990 | Te tjera |
| 635 | 85153100 | Plotesisht ose pjeserisht automatike |
| 636 | 85153913 | Transformatoret |
| 637 | 85153918 | Gjeneratoret apo konvertoret rrethore apo konvertoret statike, rektifikuesit apo aparatet rektifikuese |
| 638 | 85153990 | Te tjera |
| 639 | 85158011 | Per saldim |
| 640 | 85158019 | Te tjera |
| 641 | 85158091 | Per saldim me rezistence te plastikave |
| 642 | 85158099 | Te tjera |
| 643 | 85159090 | Te tjera |
| 644 | 85261090 | Te tjera |
| 645 | 85269290 | Te tjera |
| 646 | 85301000 | Pajisje per rruget hekurudhore ose tramvajet |
| 647 | 85308000 | Pajisje te tjera |
| 648 | 87011000 | Motokultivatore |
| 649 | 87012010 | Te reja |
| 650 | 87012090 | Te perdorura |
| 651 | 87051000 | Makinatvinc |
| 652 | 87052000 | Shpuesit derrike te levizshem |
| 653 | 87053000 | Makinat shuarse te zjarrit |
| 654 | 87054000 | Autobetonieret |

| | | |
|---|---|---|
| 655 | 87059010 | Kamionet e avarise |
| 656 | 87059030 | Mjetet e transportit per pompimin e betonit |
| 657 | 87059090 | Te tjera |
| 658 | 87091990 | Te tjera |

**VENDIM**
**Nr.566, datë 23.8.2006**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, 16 e 18 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Republikën e Shqipërisë, më poshtë e quajtur AKKP-ja, është person juridik, publik, në varësi të Ministrit të Drejtësisë.
2. AKKP-ja ka zyrën qendrore në Tiranë dhe 12 zyra rajonale në qarqe. Kjo agjenci, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, është e hapur për publikun dhe në shërbim të subjekteve të shpronësuara a të trashëgimtarëve të tyre, gjatë gjithë orarit zyrtar të punës. Çdo kufizim brenda orarit zyrtar, për aplikim, shtim/korrigjim dokumentacioni, takim, këshillim, me punonjësit e agjencisë, përcaktohet me urdhër të brendshëm të drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së.
3. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave përmbush objektivat, kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë, e përcaktuara në nenet 15 e 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.
4. Organika dhe struktura e AKKP-së (zyra qendrore dhe zyrat rajonale) përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave".
5. AKKP-ja drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe 2 (dy) zëvendësdrejtorë.

5/1.Drejtori i Përgjithshëm, përveç detyrave dhe përgjegjësive të parashikuara në ligj, ushtron dhe këto përgjegjësi:

a) Përfaqëson dhe drejton agjencinë;

b) U kërkon drejtuesve rajonalë shpjegime, relatime dhe verifikime administrative, për çështjet që ata mbulojnë;

c) Pezullon zbatimin e akteve të brendshme të drejtuesve rajonalë, me nismën e vet ose me kërkesë të subjekteve të interesuara, kur vëren shkelje të ligjeve, të akteve të Këshillit të Ministrave ose akteve, mbi të cilat mbështetet funksionimi i kësaj agjencie;

ç) Raporton, informon dhe i relaton për veprimtarinë e agjencisë ministrit të Drejtësisë, si dhe zbaton udhëzimet e tij;

d) Raporton në institucionet kushtetuese, sipas këtij vendimi.

5/2. Dy zëvendësdrejtorët drejtojnë, përkatësisht, në nivel kombëtar, strukturat e mëposhtme:

a) Drejtorinë e Kthimit të Pronave, përgjegjëse për shqyrtimin, ndjekjen dhe zgjidhjen, sipas ligjit, të kërkesave të subjekteve të shpronësuara, përditësimin e të dhënave në regjistër për çështjet e shqyrtuara (njohje, kthim a kompensim pronash), regjistrimin pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendimeve, ku disponohet, në favor të subjektit të shpronësuar, e drejta e pronësisë për pasuri të paluajtshme apo të drejta reale të lidhura me to, si dhe çdo detyrë tjetër, të caktuar nga drejtori i Përgjithshëm i agjencisë.

b) Drejtorinë e Kompensimit të Pronave, përgjegjëse për evidentimin e subjekteve dhe përgatitjen e të dhënave të regjistrit për subjektet e shpronësuara, që përfitojnë kompensim, sipas këtij ligji, përllogaritjen e faturës financiare, administrimin dhe shpërndarjen, sipas ligjit, të fondit të kompensimit, të vënë në dispozicion, si dhe çdo detyrë tjetër, të caktuar nga drejtori i Përgjithshëm i agjencisë .

6. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga Këshilli i

Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, ndërsa 2 zëvendësdrejtorët emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Drejtori i Përgjithshëm dhe 2 zëvendësdrejtorët e agjencisë propozohen nga radhët e personave të aftë profesionalisht, me përvojë në drejtim dhe integritet të lartë personal.

Kryeministri, në urdhrin e emërimit, përcakton zëvendësdrejtorin përgjegjës, i cili në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm, ka të drejtën të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë, për përfaqësimin e AKKP-së, për çështjet e përcaktuara në nenin 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, të ndryshuar.

7. Drejtuesit e zyrave rajonale emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë. Ata përzgjidhen ndërmjet kandidatëve, shtetas shqiptarë, të aftë profesionalisht, me përvojë në drejtim dhe me integritet të lartë personal.

8. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së apo të drejtorit të zyrës rajonale të kthimit dhe kompensimit të pronave, në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, ushtrohen kur vendi mbetet vakant për më shumë se 10 ditë kalendarike, drejtpërdrejt, sipas nenit 34 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", nga zëvendësdrejtori, që mban këtë tagër në urdhrin e emërimit të tij në detyrë.

Në çdo rast, AKKP-ja evidenton, në regjistrat e veta, në mënyrë të saktë, periudhën e zëvendësimit dhe e bën publike për çdo të interesuar, duke e vendosur edhe në faqen e internetit të agjencisë. Ky informacion përditësohet çdo javë.

Për çdo detyrë a përgjegjësi tjetër, zëvendësimi a delegimi i përgjegjësive kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Drejtori i Përgjithshëm i raporton, me shkrim, periodikisht, çdo tre muaj, Kryeministrit dhe Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financën, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Raporti përmban:

a) të dhënat e përgjithshme për ecurinë e procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave dhe mbarëvajtjen e tij, si dhe detyrimin për të raportuar për sipërfaqen dhe vlerën në lekë;

b) numrin e kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara, të ndara në nivel qarku dhe në shkallë vendi, si dhe llojin e pasurisë;

c) numrin e kërkesave të shqyrtuara në zyrat rajonale, raportet e kthimit dhe kompensimit, indeksin e saktë të çështjeve të pranuara a të rrëzuara, si dhe numrin e çështjeve të ankimuara në zyrën qendrore;

ç) numrin e kompensimeve, të kryera nga zyra qendrore;

d) numrin e ankimimeve, të shqyrtuara nga Drejtori i Përgjithshëm, si dhe indeksin e çështjeve, për të cilat është vendosur pranimi i ankimit, rrëzimi apo zgjidhja në themel;

dh) numrin e vendimeve të formës së prerë;

e) të dhënat për nivelin e bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore;

ë) indeksin e rasteve të ankimit gjyqësor;

f) të dhënat për politikën e ndjekur nga agjencia, për çështje të kontrollit të ligjshmërisë, luftës kundër korrupsionit, konfliktit të interesit, mitmarrjes apo favorizimeve të tjera, të paligjshme;

g) të dhënat për trajtimin e denoncimeve nga qytetarët;

gj) të dhënat për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që, sipas vlerësimit të drejtorit të Përgjithshëm, duhet të vihet në dijeni Kryeministri dhe/apo komisioni përkatës i Kuvendit.

Të dhënat e përcaktuara nga shkronja "a" deri në shkronjën "g" dhe të dhënat e tjera, që kanë lidhje me procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, për subjektet e shpronësuara, bëhen publike në faqen elektronike të agjencisë brenda 2 javësh nga dorëzimi i raportit.

10. Drejtori i zyrës rajonale u raporton me shkrim, çdo muaj, Drejtorit të Përgjithshëm dhe prefektit të qarkut. Raporti përmban:

a) të dhënat e përgjithshme për ecurinë e procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave në qark dhe për mbarëvajtjen e këtij procesi, si dhe detyrimin për të raportuar për sipërfaqen dhe vlerën në lekë;

b) numrin e kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara dhe llojin e pasurisë, objekt kërkimi;

c) numrin e kërkesave të shqyrtuara dhe raportet e kthimit dhe të kompensimit, indeksin e saktë të çështjeve të pranuara a të rrëzuara, si dhe numrin e çështjeve të ankimuara në zyrën qendrore;

ç) të dhëna për nivelin e bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore të qarkut;

d) indeksin e rasteve të ankimit gjyqësor;

e) të dhëna për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që, sipas vlerësimit të drejtorit të zyrës rajonale, duhet të vihet në dijeni drejtori i Përgjithshëm apo prefekti.

Raporti për Drejtorin e Përgjithshëm duhet të përmbajë edhe informacion për mënyrën e zbatimit të politikës së zyrës rajonale, performancën e personelit të punësuar në këtë zyrë, zbatimin dhe ndjekjen e buxhetit, zbatimin e detyrave dhe të përgjegjësive, të lëna nga Drejtori i Përgjithshëm, raportet e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion të Këshillit të Ministrave apo raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

11. Agjencia i ushtron funksionet e veta në përputhje me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative, ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, si dhe me aktet e brendshme të Drejtorit të Përgjithshëm.

Të gjithë punonjësit e AKKP-së, që, sipas detyrës funksionale, pranojnë, ndjekin, plotësojnë, shqyrtojnë apo hetojnë, paraprakisht, kërkesat e subjekteve të shpronësuara apo përgatisin projektaktin a relacionin shoqërues, për çështje të shqyrtimit dhe vendimmarrjes së drejtorit të Përgjithshëm apo të Drejtorit të zyrës rajonale, sipas nenit 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", kanë përgjegjësinë t'i dokumentojnë veprimet që kryejnë edhe në dosjen, ku regjistrohet kërkesa dhe vendoset dokumentacioni provues.

Evidentimi i veprimeve, në kuptim të këtij vendimi, kryhet nëpërmjet përfshirjes në dosje të çdo shkrese, që i bashkëlidhet praktikës, si dhe nëpërmjet depozitimit të të gjitha procesverbaleve, kujtesave, informacioneve, akteve të vlerësimit a ekspertimit, të përgatitura, sipas rastit apo çdo shkresë tjetër për të tretë apo të brendshme, për trajtimin e kësaj kërkese. Në kuptim të këtij detyrimi, sektori juridik në zyrën rajonale apo/dhe sektori juridik në qendër, kanë përgjegjësinë ligjore të bëjnë vlerësimin e kërkesës dhe të rrethanave të paraqitura, për çështje të bazueshmërisë së saj në ligj dhe në prova. Vlerësimi ligjor është pjesë përbërëse e praktikës dhe nënshkruhet nga specialisti/ët jurist, që shqyrtoi/uan praktikën dhe përgjegjësi i zyrës ligjore, që e mbikëqyri dhe pranoi atë.

12. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së ndjek dhe vë në dijeni, çdo muaj, Ministrin e Drejtësisë, për çështje të përfaqësimit të interesave ligjore të shtetit në gjykatë, gjatë zgjidhjes dhe shqyrtimit të konflikteve, në përputhje me nenin 18 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

13. Drejtuesi i zyrës rajonale dërgon në zyrën qendrore të agjencisë, brenda 7 ditëve kalendarike, një kopje të çdo akti administrativ, të marrë në përputhje me nenin 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, që i bashkëlidhet, sipas qarqeve, fondit arkivor. Ruajtja dhe administrimi i dokumentacionit në AKKP në qendër dhe në zyrat rajonale, të kryhen në përputhje me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".

14. Personeli i AKKP-së duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i agjencisë. AKKP-ja rekruton personel, specialistë, të diplomuar në degët drejtësi, urbanistikë, arkitekturë, inxhinieri, specialistë për vlerësim pasurish të paluajtshme, ekonomistë, topografë dhe personel ndihmës. Marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

15. AKKP-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe nga donacionet e huaja.

16. Prefekti i çdo qarku, jo më vonë se 10 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, mbikëqyr transferimin e arkivit, të logjistikës dhe të mjeteve të punës së zyrave rajonale dhe njofton me shkrim Kryeministrin për ecurinë e procesit. Transferimi të kryhet me procesverbal, për çdo dosje a praktikë të depozituar nga subjektet e shpronësuara. Kjo procedurë të zbatohet dhe për transferimin e çdo dosjeje nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në zyrën qendrore të AKKP-së.

17. Drejtori i Përgjithshëm bashkërendon punën në vijim me donatorët e huaj dhe organizatat ndërkombëtare për asistencën teknike në proces të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare**
**ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”,
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

**BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. **PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)……………………………………… 1500**
2. **PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) ………………………………………… 600**
3. **PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006) 1500**
4. **PËR TAKSAT DHE TATIMET…(+ suplement 2006)………………… 1500**
5. **PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT………… 500**

**Botime të reja**

1. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I)…......… 1000**
2 **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006(VëllimiII)…......… 500**
3. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I)……………..… 1000**
4. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)……………..… 500**
5. **PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË……………………………………………………………………. 1000**
6. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PUSHTETI VENDOR…………………... 800**
7. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PER NDERTIMET……………………....… 500**
8. **PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)………………………………………………………………………… 1000**
9. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE……... 500**

Hyri në shtyp më 23.8.2006
Doli nga shtypi më 23.8.2006

| Tirazhi: 4000 copë | Formati: 60x88/8 |
|---|---|

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë